

No. Prot: PR 0020
Data: 19.02.2026
Ref: RFO-05-01-2026

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Objekti i Fteses per Oferte

Sherbimi i marrjes me qira te pajisjeve me qellim printimin, fotokopjimin dhe skanimin e dokumentave nga ProCredit Bank sh.a

Banka eshte e interesuar te kontraktoje per kete sherbim shoqeri te cilat kane kapacitetet e nevojshme teknike per te ofruar ciklin e plote te ketij sherbimi ku perfishihet dhe nderrimi i bojes, monitorimi on-line i statusit te pajisjeve, riparimi dhe zevendesimi i pajisjeve ne rast te shfaqjes se problematikave te ndryshme si dhe gjenerimi i raporteve te kerkuara.

Shoqeria juaj, duhet te provoje se disponon aftesite teknike per realizimin e sherbimit te kerkuar, ne kete proces tenderimi permes dokumentacionit te kerkuar ne ftesen e detajuar per oferte

Eshte e preferueshme qe shoqeria juaj te kete **minimalisht 3 vite eksperience ne treg** si dhe te kete realizuar te pakten 3 **kontrata** sherbimi te printimit, fotokopjimit dhe skanimit te dokumentave gjate tre viteve te fundit.

Nje permbledhje e specifikimeve teknike te sherbimit te kerkuar jane:

- a. Shoqeria do te ofroje pajisjet, software-t, si dhe licencat perkatese.
- b. Sherbimi ofrohet me softwer-in e shoqerise ofertuese ose duke perdorur softwer-in e bankes.
- c. Shoqeria do te ofroje suportin e mirembajtjes perfishire dhe ndryshimin e bojes dhe monitorimin on line te statusit te pajisjes.
- d. Aksesit ne pajisjen multifunkionale do te jete nepermjet kartes individuale qe stafi ka ne perdorim (karte aksesit per levizjen ne objekt) dhe kod printimi. Ky akses do te jete per te gjitha punonjesit e Bankes pavaresisht objektit (Zyra Qendrore ose Njesi Biznesi).
- e. 5 pajisje duhet te jene te pajisura me zgjidhjen e skanimit te dokumentacionit ne formatin orgjinal.
- f. 1 pajisje duhet te kete opsionin e printimit/fotokopjimit me ngjyra.
- g. 1 pajisje duhet te kete opsionin e printimit/fotokopjimit ne formatin A3 me ngjyra
- h. Paisjet duhet te garantojne „scan to folder“ ne rrjet ne formatin PDF. (Banka perdor nje folder te caktuar per nje nga aplikacionet e saj).
- i. Aksesit ne server i software-it te printimit nga punonjesit e shoqerise do te garantohet nga Banka. Shoqeria duhet ti japi paraprakisht Bankes te gjitha portat dhe informacionet rreth rrjetit mbi te cilat funksionojne pajisjet multifunkionale dhe software-t per menaxhimin e tyre. Serveri kryesor eshte makine virtuale dhe aktualisht eshte ne ambientet e Bankes. Manaxhimi i serverit do te kryhet nga Banka. Serveri do kete Antivirus Bitdefender te instaluar dhe do marri te gjitha update-t e Windows-it.
- j. Sistemi qe do te ofrohet **duhet te kete** opsionin “Follow me Printer”, qe do te thote qe ne momentin qe printeri instalohet ne kompjuter, automatikisht te shfaqet edhe ne serverin kryesor te Bankes, qe e aksesojme nepermjet Remote Desktop Connection.

Ne vijimi, ne menyre periodike Banka kerkon pergatitjen e raporteve nga punonjesit e saj si me poshte:

1. Raport per numrin total te fleteve te shpenzuara nga cdo user si rezultat i printimeve/fotokopjimeve sipas periudhave te ndryshme te kerkuara.
2. Raport per numrin total te fleteve te shpenzuara nga te gjitha paisjet (te gjithë userat) si rezultat i printimeve/fotokopjimeve sipas periudhave te ndryshme te kerkuara.
3. Raport per numrin total te fleteve te shpenzuara nga secila paisje si rezultat i printimeve/fotokopjimeve sipas periudhave te ndryshme te kerkuara.
4. Raport per numrin e printimeve/fotokopjimeve sipas userave ne periudha te ndryshme sipas kerkeses.
5. Raport per numrin e printimeve/fotokopjimeve sipas paisjeve ne periudha te ndryshme sipas kerkeses.
6. Raport per numrin e printimeve/fotokopjimeve per te gjithë paisjet ose userat ne total ne periudha te ndryshme sipas kerkeses.

Nese jeni te interesuar per te marre pjese ne kete proces lutemi te dergoni kerkesen tuaj per terheqjen e dokumentacionit te plote te tenderit ne adresen elektronike: info_procurement@procredit-group.com jo me vone se data **27 shkurt 2026.**

Shenim i rendesishem:

Afati i fundit i dorezimit te ofertave sipas kerkesave te detajuara ne ftesen per oferte eshte data **6 Mars 2026, ora 16.00**.

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: info_procurement@procredit-group.com

Sinqerisht,
ProCredit Bank sh.a
Funksioni Prokurimit